

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.A. nga fshati ..., komuna e Ferizajit për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës nga neni 332 par.1. të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit Z.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.1460/2017 datë 07.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur 18.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit Z.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, , P.nr.1460/2017 datë 07.02.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin, , P.nr.1460/2017 datë 07.02.2018, të akuzuarin Z.A., e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës nga neni 332 par.1. të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër)muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk do të kryejë vepër të re penale. I akuzuari është obliguar që në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë ta liron nga uzurpimi i paligjshëm pronën e paluajtshme-lokalin afarist, të cilin e ka dhënë në shfrytëzim një personi tjetër, e i cili gjendet në rrugën “12 Qershori” nr.35 A, në Ferizaj, pronë e të dëmtuarve A.A. dhe B.A., e regjistruar në Certifikatën e paluajtshmërisë me nr. 42125-2017 i datës 28.04.2017, i lëshuar nga zyra kadastrale Ferizaj dhe nëse nuk e liron në mënyrë vullnetare do të ekzekutohet nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm. I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20€ dhe taksën në shumë prej 30 € konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari Z.A.,për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar dhe ta anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe vendim ose i njëjti të ndryshohet, dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Apelit me shkresën PPA/II.nr.474/18 datë 08.05.2018 ka propozuar që të refuzohet ankesa e të akuzuarit si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi i shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studio aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitë e nenit 394 të KPP, dhe pasi që i vlerësoi pretendimet në ankesë gjeti se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

I akuzuari me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje juridiko-penale nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, se i njëjti nuk e ka bërë uzurpimin e pronës së paluajtshme të të dëmtuarve-prindëve të tij, e cila patundshmëri udhëhiqet në emër të nënës së tij por konsideron se si djalë i tyre e ka të drejtën e shfrytëzimit të lokalit në mënyrë të barabartë me vëllezërit dhe motrat e tij, se objekti afarist banesor është i ndarë në 6 pjesë të njëjta por që ndarja e tyre fizike nuk është bërë ende nga babai i tij, B.A.. Me ankesë, potencohet se për shkak të fakteve të cekura më lartë, i akuzuari pjesën afariste për të cilën mendon se i takon, ia ka lëshuar me qira Nehat Brahës për sigurimin minimumit të ekzistencës materiale pasi që nuk ka burim tjetër të të ardhurave sepse nuk është i punësuar. Me ankesë pretendohet se dëshmia e prindëve të tij, tani të dëmtuarve, është e një anshme sepse atij, si birit të të dëmtuarve i takon sipërfaqja prej 100 m2 të lokalit afarist dhe 350 m2 të sipërfaqes banesore në katin e pestë, për çka janë nënshkruar edhe anëtarët tjerë të familjes. I akuzuari gjithashtu thekson se babai i tij ka kërkuar nga qiramarrësi i lartcekur që ta lirojë lokalin se më shpejt përkundër investimeve që i njëjti ka bërë në lokal dhe të njëjtit ia ka tërheqë vërejtjen se lokali është pronë e tij.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të të akuzuarit, nuk qëndrojnë. Sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejt pretendohet në ankesë. Se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është gjykuar në pa mëdyshje nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve-të dëmtuarve Bafti e A.A., dëshmitarëve M.A e N.B. e pjesërisht edhe nga deklarata e të akuzuarit, nga Certifikatën e paluajtshmërisë me nr. 42125-2017 i datës 28.04.2017, i lëshuar nga zyra kadastrale Ferizaj si dhe nga Kontrata mbi shkëputjen e bashkësisë familjare e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj, me shenjë Vr. 185/03 e datës 30.04.2003 e në të cilat përshkruhen në mënyrë të qartë veprimet inkriminuese të të akuzuarit, veprime këto të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Pretendimi ankimor i të akuzuarit sipas qëndrimit të Kolegjit penal të kësaj Gjykate, është i pabazuar, nga se nga shkresat e lëndës, e sidomos nga deponimi i të dëmtuarve B. e A.A., e duke u

bazuar në Certifikatën e paluajtshmërisë me nr. 42125-2017 i datës 28.04.2017, i lëshuar nga zyra kadastrale Ferizaj, vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale që është objekt i aktgjykimit të ankimuar, sepse paluajtshmëria e cila udhëhiqet në këtë Certifikatë është në emër të të dëmtaurës, se e njëjta nuk ka dhënë pëlqimin e saj për dhënien e lokalit me qira dhe se fakti që i akuzuari është bir i të dëmtuarëve, nuk mund të arsyetojë veprimet e të akuzuarit, e për këto arsye konstatohet se gjykata se shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë i akuzuari pretendon se dënimi i shqiptuar është i pa bazë nëse mirren parasysh rrethanat lehtësuese e që janë fakti se rasti e ka goditur shpirtërisht thellë dhe se lidhur me këtë çështje ka ankthe psikike, se pas kësaj, nuk ka kryer veprën tjetër, dhe se mare nuk ka kryer këso dhe vepra tjera penale e prandaj konsideron se janë plotësuar kushtet që i akuzuari, në mungesë të provave, të lirohet nga akuza ose që çështja të kthehet në rigjykim.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjkata e Apelit vlerëson se pretendimet e të akuzuarit për lirimin e tij nga akuza, nuk janë të bazuara. Gjkata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 dhe 74 të KPK-së, me ç' rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar, se më parë nuk ka qenë i dënuar, se jeton vetë dhe sjelljen e të akuzuarit gjatë procedurës ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke aplikuar dispozitën e nenit 73 dhe 74 të KPPK, duke vlerësuar faktin se në ankesën e të akuzuarit nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që i akuzuari të lirohet nga akuza, në mungesë të provave, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuari ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 467/18 me datë 18.05.2018

Bashkëp. Profesional
Jeton Leci

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Afrim Shala